



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:049636
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05839765

C.nr.1840/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Erlinda Elezi Tosku, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.B nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.M, avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 1,439.10 euro, jashtë seancës, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.B nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, që në emër të kualifikimit shkollim i lartë pedagogjik për periudhën nga data 01.02.2021 – 30.04.2022, për 15 muaj, duke llogaritur nga 38.95 euro për çdo muaj, t’ia paguaj paditëses shumë prej 584.25 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 07.02.2024 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkuar më tepër se shuma e gjykuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 07.02.2024, ka paraqitur padi, kurse me dataë 19.04.2024 ka paraqitur parashtrësen për precizimin e padisë në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 1,439.10 euro.

Në padi të dt. 07.02.2024 dhe parashtrën e dates 19.04.2024, ka theksuar se i njëjti është i punësuar në Shkollën Filllore të Mesme e Ulët (në vijim: SHFMU) “Abaz Ajeti” në Gjilan, në cilësinë e mësimitdhënës me kualifikim fakultet. Përkundër kualifikimit të tij fakultet, asnjëherë nuk është kompensuar për aq sa e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën kohore nga data 01.01.2021 – 06.02.2023, i njëjti është kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro për çdo muaj, ndërsa është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro (sipas 27 % të pagesë bazë), me ç’rast e paditura i ka mbetur borxh në shumën prej 55.35 euro në muaj. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 1,439.10 euro, në emër të kualifikimit me master për periudhën nga dt.01.01.2021 -06.02.2023, për 26 muaj, nga 55.35 euro në muaj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 31.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie punë tek e paditura (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pacaktuar së paditëses me të paditurën, nr.prot.939, e dt.01.09.2015).

Nuk është kontestuese se i njëjti ka diplomë të nivelit fakultet –shkollim të lartë pedagogjik nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit -Gjilan (fakt i vërtetuar edhe nga diploma

nr.958 e dt.21.12.2011), është mësimdhënës i licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100001094 e dt.11.09.2012) dhe se pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim është paguar në shumën prej 41.04 euro (fakt i vërtetuar edhe nga lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit, pasi ka gjetur se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me shkollim të lartë pedagogjik, meqë është paguar në shumën prej 41.04 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, ndërsa është dashur të paguhet në shumën prej 79.99 euro (prej 19% të pagës bazë), me ç'rast e paditura i ka mbetur borxh në shumën prej 38.95 euro, në muaj.

Meqë e paditura është thirrë në parashkrim, gjykata bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, gjeti se kërkesa e paditësit është kërkesë monetare e cila parashkruhet brenda 3 vite nga data e paraqitjes së kërkesës, e në rastin konkret e refuzojë kërkesëpadinë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi vlerëson se periudha kohore e kërkuar për kompensimin në emër të kualifikimit në pagë është pjesërisht e përfshirë në parashkrim, sepse padia është ushtruar më datë 07.02.2024, në bazë të kësaj dispozite ligjore, kërkesa duhet llogaritur nga data 01.02.2021, ndërsa paditësi kompensimin e ka kërkuar nga data 01.01.2021. Në rastin konkret periudha për muajin Janar 2021, është e përfshirë në parashkrim.

Po ashtu, sa i përket kërkesës për kompensimin e kualifikimit, paditësi ka kërkuar këtë kompensim deri me datë 06.02.2023, kurse i njejtë me datë 07.05.2022, ka arritur moshën e pensionimit dhe atë bazuar në të dhënat e leternjoftimit ku vërtetohet se paditësi është i lindur me datë 07.05.1957, prandaj për të njejtin gjykata ka vendosur që të njejtë t'i aprovohet kompensimi për kualifikim deri në muajin Prill të vitit 2022, përveç kësaj paditësi sipas kërkesëpadisë ka kërkuar që të kompensohet për kualifikimin me fakultet sipas përqindjes prej 27%, të pages bazë, por megjithatë gjykata pasi që, shikoj shkresat e lëndë dhe atë diplomën e paraqitur nga paditësi vërtetoi se i njejtë është i kualifikuar me shkollim të lartë pedagogjik dhe që me këtë rast sipas dispozitave të lartëcekura ligjore, u vendos se të njejtë i takon kompensimi për kualifikim me shkollim të lartë pedagogjik, sipas përqindjes prej 19 %, të pages bazë, ashtu siç është vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1840/24, më datë 19.06.2024

Gjyqtarja,
Erlinda Elezi Tosku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:049636
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05839765